**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)**
**IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**


MUNICIPALITY
14.02 2020
Numër | Shtojca | Vlera
01- 060- 6607


**Komuna / Opština: Drenas   Data / Datum: 12.02.2020**

**Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini:** 1

**Takim i rregullt / Redovni sastanak** ☒ **Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak** ☐

**Numri i anëtarëve të KKSB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 17**

**A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSB-së?**
**Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?**

Po / Da ☐
Jo / Ne ☐
Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☒

**A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSB-së?**
**Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?**

Po / Da ☒ *Përfaqësues të KFOR-it dhe OSBE-së.*
Jo / Ne ☐

*Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë*
*Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju*

**A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo Nënkryetari?**
**Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?**

Po / Da ☒ **Nënkryetari**
Jo / Ne ☐

**Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:**

*Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:*

1. *Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur më 18.12.2019;*
2. *Draft plani i punës së KKSB-së për punën e vitit 2020;*
3. *Draft orari i punës së KKSB-së për vitin 2020;*
4. *Diskutim lidhur me dukuritë negative në shkolla dhe për mundësitë e vendosjes së kamerave të sigurisë;*
5. *Diskutim lidhur me kërkesën e Qendrës për Hulumtime dhe Politika të Sigurisë (SPRC) për bashkëpunim;*
6. *Të ndryshme.*

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur mbledhjen e parë të rregullt për këtë vit të cilën e kryesoi nënkryetari i Komunës së Drenasit, Nazmi Hasi.

Të pranishëm ishin shumica e anëtarëve e KKSB-së, monitorues nga OSBE-ja dhe përfaqësues nga KFOR-LMTK15.

- Pika e parë, e dytë dhe e tretë u aprovuan unanimisht.

- Për pikën e katërt, u kërkua që të krijohen mundësitë për mbajtjen e orëve të kujdestarisë dhe se pas sqarimeve të Drejtoreshës së DShPE-së, Lumnije Krapi, konkluzioni ishte se justifikimet për mos mbajtje të orëve të kujdestarisë të lidhura me çështje të transportit nuk qëndrojnë. Megjithatë, u dakordua që të bëhet një koordinim më i mirë i akterëve duke përfshirë edhe Drejtorinë e Inspeksionit.

  Në mbledhje, për këtë çështje, gjithashtu u kërkua edhe angazhim më i madh i pedagogut dhe psikologut të shkollës si dhe që DKA të bëjë kërkesë drejtuar MAShT-it që orët e kujdestarisë në shkolla të bëhen obligative.

  Përfaqësuesit e policisë deklaruan se policia është e pranishme në afërsi të shkollave dhe se veprojnë në respekt të autoritetit të shkollave.

  Nënkryetari Nazmi Hasi, Drejtori i DKA-së, dhe Arben Nika, përfaqësues nga EVSB, sqaruan për të pranishmit se për momentin një Komision është duke hartuar një rregullore për organizimin e punës në institucionet edukative-arsimore dhe kjo do të ndihmojë në përmirësimin e situatës në shkolla.

  Muhamet Gjoka, Drejtor i Arsimit në Komunën e Drenasit, i njoftoi të pranishmit me përpjekjet nga kjo drejtori për sigurimin e kamerave për disa nga shkollat e Drenasit.
  Në mbledhje u theksua edhe mungesa e një mediumi lokal përmes të cilit do të promovohej edhe puna e KKSB-së dhe do t'i përcillte aktivitetet tjera rinore dhe kulturore.

- Pika e pestë, kërkesa e Qendrës për Hulumtime dhe Politika të Sigurisë (SPRC) u aprovua për mbledhjen e radhës më 15 prill.

- Për pikën e gjashtë nuk pati diskutime.

**Procesverbali aprovohet nga Kryetari:**

**Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrovci** ______________________

nënshkrimi / potpis

**Data e aprovimit / Datum odobravanja:** 14.02.2020

***Rekomandimet:***

- *Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;*
- *Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;*
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën:* mpb.dsb@rks-gov.net
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën:* Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net
- *Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.*